**VENDIM**
**Nr. 145, datë 20.2.2013**

# PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME PËRFAQËSUES NË SHTABIN "EUFOR", NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK "ALTHEA", TË BASHKIMIT EUROPIAN, NË BOSNJË-HERCEGOVINË

*(Ndryshuar me VKM nr. 396, datë 18.6.2014; nr. 178, datë 25.2.2015; nr. 819, datë 18.12.2019; nr. 37, datë 16.1.2025)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 pika 5, e 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Dërgimin me mision në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, në kuadër të operacionit ushtarak "ALTHEA", të Bashkimit Evropian:*

*a) të 1 (një) përfaqësuesi ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në shtabin "EUFOR";*

*b) të 30 (tridhjetë) ushtarakëve në nivel "togë këmbësorie" nga Forca Tokësore e Republikës së Shqipërisë, në përbërje të kompanisë së pestë të manovrës së batalionit kinetik të Turqisë.*

2. Misioni i *përfaqësuesve* ushtarak, në kuadër të operacionit ushtarak "ALTHEA", është drejtimi, monitorimi, këshillimi i Forcave të Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës për të gjitha çështjet në lidhje me stërvitjen kolektive, me qëllim implementimin dhe arritjen e aftësive mbrojtëse *si dhe garantimi i një mjedisi të sigurt për rritjen dhe forcimin e stabilitetit të shoqërisë në Bosnjë-Hercegovinë.*

*3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 31 dhjetor 2028. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.*

4. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për *përfaqësuesit* ushtarak pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet për:

*a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;*

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shërbimin telefonik dhe internet;

dh) transport;

e) trasportimin e individit të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast *thyerje disipline,* vdekjeje ose sëmundjeje;

ë) akomodim (fjetje, ngrohje, ujë);

f) ushqim;

g) energji elektrike, ujë të pijshëm, lavanderi;

gj) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kryerjes së misionit;

h) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

5. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i cili do të marrë pjesë në këtë mision.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**